

## Letërsia moderne shqipe

Informatat themelore:	
Njësia akademike:	Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Filologjisë – Dega e Letërsisë Shqipe
Lënda:	Letërsia moderne shqipe
Niveli:	Bachelor
Statusi:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti III - Semestri VI
Numri i orëve në javë:	3+2
Kreditë ECTS:	6 ECTS
Koha / Vendi:	Salla 76 - Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. dr. Nysret Krasniqi
Të dhënat kontaktuese:	nysret.krasniqi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	<p>Kursi <i>Letërsia moderne shqipe</i> mundëson që studentët të marrin njohjen adekuate, leximin, studimin dhe interpretimin individual të letërsisë moderne shqipe, duke e parë në shfaqjen, orientimin dhe kontekstin e saj letrar e kulturor.</p> <p>Përveç kësaj, studiohen fenomenet, kahjet tematike-stilistike në konstituimin e modernitetit, për t'i shenjuar këto fenomene të format e poezisë, prozës dhe të dramës shqipe. Një kujdes i shtuar do t'i kushtohet edhe informimit dhe hulumtimit në fushë të studimeve teorike-kritike të autorëve të modernitetit shqiptar.</p>

**Qëllimet e lëndës:**

Kursi *Letërsia moderne shqipe* ua mundëson studentëve njohjen me modernitetin e letrave shqipe, duke përfshirë hetimin e rrymave moderne të krijimit, individualizimin e autorit në letërsinë shqipe, shfaqjen dhe konsolidimin e të gjitha formave letrare, si dhe kahjet e mendimit teorik-kritik për problemet e letërsisë, por edhe të kulturës nacionale në përgjithësi. Përveç kësaj, studentët do të pajisen me dije dhe shkathtësi metodologjike e teorike, e cila do t'ua mundësojë hulumtimin, analizimin e studimin e pavarur të teksteve letrare shqipe.

**Rezultatet e pritshme të nxënies:**

Të identifikojë dhe të hulumtojë korpusin e letërsisë moderne shqipe

Të diferencojë temat, format dhe stilet e shkrimit modern letrar

Të gjykojë për fenomene, vepra e autorë të modernitetit shqiptar

Të formulojë pikëpamjet individuale për zhvillimin dhe konsolidimin e letërsisë moderne shqipe

Të zhvillojë mendimin individual kritik-teorik për problemet dhe fenomenet e letërsisë moderne shqipe

**Ngarkesa e studentit**

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime	2	15	30
Punë praktike			
Konsultime me mësimdhënësin	0.5	6	3
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit			10
Detyrë shtëpie	2	15	30
Mësimi individual	2	15	30

Përgatitja për provimin final		4
Koha e vlerësimit		3
Projektet, prezantimet, etj.		
<b>Total</b>		<b>155:25, 6.2</b>
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata, ushtrime, seminare dhe konsultime.	
Metodat e vlerësimit:	Vijueshmëria e studentit 20 %; Vlerësimi i parë: 30 %; Vlerësimi i dytë: 30 %; Seminari: 20 %	
Literatura primare:	<i>Shkrimtarë shqiptarë I, II, 1941-42</i> Gaetano Petrotta: <i>Populli, gjuha dhe letërsia shqiptare</i> , 1932 Sabri Hamiti: <i>Letërsia moderne</i> 8, 2002 Robert Elsie: <i>Historia e letërsisë shqipe</i> , 1995 Sabri Hamiti: <i>Testamenti</i> , 2018	
Literatura shtesë:	Eqrem Çabej: <i>Për gjenezën e literaturës shqipe</i> , 1938 Sabri Hamiti: <i>Enigma e poezisë</i> , 2020 Mensur Raifi: <i>Fan Noli dhe Migjeni</i> , 1979 Dhurata Shehri: <i>Koliqi mes malit dhe detit</i> , 2006 Kujtim M. Shala: <i>Kujtesa e tekstit</i> , 2003 Nysret Krasniqi: <i>Autori në letërsi</i> , 2009 Arshi Pipa: <i>Letërsia shqipe: Perspektiva shoqërore</i> , 1978 Krist Maloki: <i>Refleksione</i> , 2005 Rene Wellek: <i>Konceptet e kritikës</i> , 1963 Dhurata Shehri: <i>Statusi i kritikës</i> , 2013 David Lodge: <i>Modern Criticism and Theory</i> , 2000	

### Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjërates
Java 1:	Letërsia moderne shqipe dhe konteksti i saj letrar e kulturor
Java 2:	Shndërrimet e poezisë dhe konstituimi i prozës
Java 3:	Elemente të dramës e të dramatikës
Java 4:	Lasgush Poradeci: 1. <i>Vallja e Yjeve</i> , 2. <i>Ylli i Zemrës</i> , 3. <i>Ekskursioni teologjik i Sokratit</i> , 4. <i>Kamadeva</i>
Java 5:	Ethem Haxhiademi: 1. <i>Abeli</i> , 2. <i>Skënderbeu</i>

Java 6:	Ernest Koliqi: 1. <i>Hija e Maleve</i> , 2. <i>Tregtar flamujsh</i> , 3. <i>Pasqyrat e Narçizit</i> , 4. <i>Gjurnat e stinve</i>
Java 7:	<b>Vlerësimi i parë</b>
Java 8:	Mitrush Kuteli: 1. <i>Net shqiptare</i> , 2. <i>Ago Jakupi e të tjera rrëfime</i> , 3. <i>Tat Tanushi i Bubutimës</i> , 4. <i>Poem kosovar</i>
Java 9:	Millesh Gjergj Nikolla: 1. <i>Vargjet e lira</i> , 2. <i>Novelat e Qytetit të Veriut</i>
Java 10:	Haki Stërmilli: 1. <i>Sikur t'isha djalë</i> ; Sterjo Spasse: 1. <i>Nga jeta në jetë – Pse?!</i>
Java 11:	Faik Konica: <i>Kritika letrare</i> ; Luigj Gurakuqi: <i>Vargnimi n'gjuhë shqype</i> ; Fan S. Noli: <i>Introduktat</i>
Java 12:	Midhad Frashëri: <i>Naim Be Frashëri</i> ; Ernest Koliqi: <i>Dy shkollat letrare shkodrane</i> ; Eqrem Çabej: <i>Për gjenezën e literaturës shqipe</i>
Java 13:	Krist Maloki: <i>A asht poet Lasgush Poradeci I,II</i> ; Mitrush Kuteli: <i>Lasgush Poradeci</i> ; Vangjel Koça: <i>Romani i mohimit</i>
Java 14:	<b>Vlerësimi i dytë</b>
Java 15:	<b>Dorëzimi i seminarit</b>

#### **Politikat akademike dhe kodi i sjelljes:**

Gjatë ligjëratave, ushtrimeve, diskutimeve në klasë duhet të dëshmohet përkushtim dhe pjesëmarrje aktive në procesin mësimor-shkencor.